



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:073828

Datë: 20.12.2019

Numri i dokumentit: 00726348

**P.nr.47/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hektor Bujupaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. K. nga Peja Rr. “...”, nr.12, për shkak të kryerjes së veprës penale, *posedim i paautorizuar i substancave piko trope*, parashikuar nga neni 275 par.1 të KPRK-së, e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II Nr.04/19,të datës, 24.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 16.12.2019, në prezencë të Prokurores së shtetit, Sadije Muriqi, të akuzuarit A. K., të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 20.12.2019 , përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**A. K.** , i lindur me “Data e lindjes” , me numër leternjoftimi...., i biri i G. dhe nënës M. e gjinisë SH., i gjendjes së mesme ekonomik, beqar, punon në “F...”, si operator në makinën e palimit, me Nr. tel...., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me parë e gjer me datë.05.10.2018, rreth orës 22 :00, në Pejë, në oborrin e Gjinnazit “B...”, pa autorizim posedon narkotik, në atë mënyrë që, pasi që i pandehuri ndalohet nga ana zyrtarëve policor dhe atë të patrullës me përbërje prej B. GJ., A. K., V. G. dhe A.in A., ku këta të fundit sipas detyrës zyrtare po kontrollonin oborrin e shkollës së lartë cekur, hasin në të pandehurin dhe shoqëruesin e tij, N. S., ku pas legjitimitit i pandehuri A. ka njoftuar zyrtaret e policisë se posedon lëndë narkotike në formë të barit me ngjyrë të gjelbër dhe se të njëjtin e ka për konsumim, e cila sasi pas konfiskimit është matur dhe analizuar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikut me Narkotik, ku ka rezultuar të jetë narkotik i llojit Marihuanë me peshë të përgjithshëm 2.9 gram.

-Me çka ka kryer veprë penale, **posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko – trope ose analoge**, parashikuar nga neni 275 par.1, të KPRK- së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 1, 9, 10 par.1 17 par.1 21, 41, 42, par.1 nëpar.1.1, 45, 46,47, 49, 50, 51, par.1 52, 73, 74, të KPRK-së, dhe nenit 275 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 453 par.4 dhe nenit 463 të KPPK-së, të akuzuarit A. K. i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBË SI DHE DENIM ME BURGË ME KUSHT**

**-DENIM ME GJOBË**, në shumë prej 500 (pesëqind) euro, e të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në fat prej 15 (pesëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Nëse i njëjti nuk e ekzekuton dënimin me gjobë, refuzon apo dështon ta paguaj, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 25 ditësh, duke i llogaritur për çdo ditë vlerën nga 20 euro, si dhe

**- DENIM ME BURGË ME KUSHTË**, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutua, nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen veprë të re penale.

Ndaj të A. K. në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, shqiptohet

### **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE/KONFISKIMI**

Konfiskohet substanca narkotike e llojit **marihuan**, me peshë neto prej 2.4 gramë nga pesha e përgjithshme prej 2.9 gram, bazu në rezultatet –raportin e analizës së narkotikëve për numër të rastit:2018-DA-2031 të dt. 09.10.2018 te Njësitit te Hetimeve për Narkotikë-Pejë.

**-URDHËROHE**, qe substanca të shkatërrohen menjëherë.

-Obligohet i akuzuari në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 25 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 15 €.

-Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të paguaj shumën prej 30 €, komfor dispozitës së nenit 39 par. 1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensim të Viktimave.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II Nr.04/19 të datës 24.01.2019, kundër të akuzuarit A. K. nga Peja për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 16.12.2019, Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të shtetit, PP/II Nr.04/19, të datës 24.01.2019, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata, është bindur se, i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq që ka ndodhur, këto shkaktohen nga pakujdesia dhe është penduar për lëndimet që janë shkaktuar.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse pranimi i fajësisë është i mbështetur në provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës dhe kërkon nga Gjykata që të bënë këtë pranim të fajësisë së të akuzuarit.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës komfor nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i zyrtarëve policor B. GJ. dhe Ragip Mulaj i dt.05.10.2018, deklarata e të pandehurit A. K. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt.05.10.2018, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, lista e dëshmimeve nga njësia e forenzikës, foto dokumentacioni i provës materiale, raport i provës materiale, raport i analizës së narkotikëve nga DHTN – Pejë, si dhe provat tjera e që janë pjesë e shkresave të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim komfor nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë qysh në fillim, pati sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale komfor nenit 41 të KPRK-së.

Ndaj të akuzuarit e në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i substancës narkotike të llojit – me peshë neto prej 2.4 gramë nga pesha e përgjithshme prej 2.9 gram, bazu në rezultatet –raportin e analizës së narkotikëve për numër të rastit:2018-DA-2031 të dt. 09.10.2018 te Njësitit te Hetimeve për Narkotikë-Pejë, duke pas parasysh se substanca i nënshtrohen konfiskimit të detyrueshëm, sipas nenit 282 par. 1,2 pika 2.2 të KPRK-së, ngase substanca e gjetur tekë i pandehuri ka rezultuar me kryerjen e veprës penale.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nen par. 2.1, dhe 2.6 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 25 (njëzetepesë) euro dhe për paushallin gjyqësor

shumën prej 15 (pesëdhjetë) euro duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Vendimin në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30 euro , gjykata e mori në përputhje me nenin 39 par.1,2,3 nënpar .3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**-Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.47/19 i dt.20.12.2019**

**Bashkëpunëtor profesional**  
Hektor Bujupaj

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Dr.sc. Murat Hulaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.